



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 120/13
Prishtinë, më 22.07.2013, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziri dhe Sevdije Lama.

Mungoi: Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Imba Rudaku dhe Arbëreshë Kosumi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj- Ministër i Financave, Lulzim Rafuna- MF, Enis Spahiu- MF, Sadete Zogaj- Kosovapress, Besian Bicurri- KDI/TIK, Lejla Selimi- Osce, Dragana Djukic- RTK2, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Rishqyrtimi i vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat më tarif zero të tatimit doganor;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-211 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare “ISTISNA’A” dhe Marrëveshja për Agjencinë “ISTISNA’A” për Financimin e vazhdimet të ndërtimit të rrugës Milloshevë-Mitrovice, Rruga M2, e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-207 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime që rregullon aktivitetet e Bankës Evropiane për Investimet në Republikën e Kosovës;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-210 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare në mes të Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim-Financimi i Dytë Shtesë për Projektin e Pastrimit të Sektorit të Energjisë dhe të Bonifikimit të Tokave-CLRP;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligji nr. 04/L-058;

8. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit për gjashtemujorin e parë të vitit 2013;

9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja njoftoj se pikë e rendit të ditës është edhe shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, arsyetja pse është futur kjo pikë është sepse këtu të gjithë jemi anëtarë të subjekteve politike dhe bashkarisht mund të japim zgjidhje më të mira dhe do të kemi mundësi të harmonizohemi brenda Komisionit.

Albana Fetoshi sugjeron që pika e shtatë e rendit të ditës të hiqet dhe të formohet një grup punues, pasi që gjatë kësaj jave nuk është pikë e rendit në Seancë Plenare, pra kemi kohë të realizojmë si duhet. Nëse e kalojmë ligjin konsideroj se nuk kemi bërë asgjë.

Me shtatë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Sevdije Lama) një votë Kundër (Albana Fetoshi) dhe një Abstenim (Xhevdet Neziraj) miratohet rendi i ditës, pa ndryshime.

2. Rishqyrtimi i vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat më tarif zero të tatimit doganor

Kryetarja vlerësoj se është një ligj i rëndësishëm, është në favor të biznesit por që ka mbetur disa muaj në Kuvend, prandaj është mirë që të gjejmë një zgjidhje dhe të jetë brenda suazavës të legjislacionit ekzistues. Pika 4 e nenit të këtij ligji në fillim ka qenë që aneksi i cili i është bashkuar këtij ligji të ketë mundësi të ndryshohet me një vendim të Qeverisë, kjo nuk është pranuar nga Presidentja. Kemi provuar që vendimin ta merr Kuvendi mirëpo prapë nga reagimet e shumta është shtyer edhe për një Seancë.

Besim Beqaj meqenëse kemi përkrahur rekomandimin e fundit të Komisionit për Buxhet dhe Financa që me një vendim të veçantë Kuvendi të merr vendim për aprovimin e listës shtesë e cila do të duhej të ishte. Gjatë Seancës u diskutua se është e nevojshme edhe një herë harmonizimi në mes të grupeve parlamentare dhe Komisioni për Legjislacion në mënyrë që të silltet për diskutim në Seancën e radhës. Në konsultim me Zyrën e Presidentes kemi ardhur deri tek një sugjerim që neni 3,4 të bëhen amendamente. Neni 3 në rreshtin 5 dhe 6 fjalët që janë pjesë përbërëse e këtij ligji të zëvendësohet me fjalën bashkangjitur. Neni 4 në rreshtin e 5 fjala të këtij ligji zëvendësohet me akt nënligjor. Ideja është që aneksi të mos bëhet pjesë e drejtëpërdrejtë e ligjit por me akte nënligjore. Në këtë kontekst jemi të harmonizuar me Zyrën e Presidentes.

Hykmete Bajrami sqaroj se qysh kur është kthyer ligji nga Presidentja kam pasur amendament në Seancë pastaj në Komision por nuk është marrë parasysh. Amendamenti ka qenë që Aneksi 1 i ligjit të ndryshohet me plotësim dhe ndryshim të ligjit, besoj se gjithë ligji ka të bëjë me listën e mallrave. Si komision kemi pasur presione në Ministrinë e ndryshme për të shtuar mallra të caktuara. Nuk mendoj se Qeverisë të i lihet kompetenca për shtimin ose heqjen e mallrave të ndryshme, kjo duhet të lihet si pjesë e ligjit dhe të bëhet me plotësim dhe ndryshim. Çdo ditë po bëjmë ligje me procedurë të përshpejtuar, pikërisht pse është refuzuar amendamenti im e kemi zgjat këtë punë, qëndroj pas mendimit tim dhe të njëjtën gjë do ta them edhe në Kuvend.

Albana Fetoshi theksoj se sipas Ministrisë se neni 4 të bëhet akt ligjor dhe Aneksi të mos ketë nevojë të vij në Kuvend për plotësim ndryshim mirëpo duhet të keni parasysh se diskutimet në Kuvend nuk kanë qenë të natyrës së tillë, deputetët kanë kërkuar që neni 4 ku thotë se Aneksi të ndryshohet nga Komisioni për

Buxhet dhe Financa në konsultim me MF. Deputetët kanë refuzuar sepse konsiderojn se edhe aneksi është pjesë e ligjit. Nuk ka kuptim që Ministria me akte nënligjore të bëjë ndryshimin e Aneksit sepse nëse e shikojmë ligjin ai është i bazuar në atë se cilët mallra do të lirohen dhe cilat jo. Pra, nëse Qeverisë i ipet kompetenca e ndryshimit të ligjit atëherë çfarë kuptimi ka me dërgu në Kuvend. Konsiderojmë se neni 4 duhet të hiqet për shkak se Aneksi duhet të vijë në Kuvend me plotësim ndryshim të ligjit.

Sali Asllanaj mendoj se është e vështirë të paramendohet diçka, një kërkesë e arsyeshme e një kompanie për ti liruar produktet nga dogana me prit me procedurë të ndryshimit të ligjit. Nëse vërtet qëndrojnë arsyet bindëse se duhet liruar biznesin vendor qëndrojnë në variantin se Qeveria me qenë më fleksibile në funksion të një ndihme të biznesit vendor. Egziston edhe mundësia e nënshtrimit të fuqishëm të bizneseve që bombardojnë me kërkesa të ndryshme. Për hir të shkurtimit të procedurave do të duhej të jemi më eficientë.

Hykmete Bajrami lirimi i mallrave nga tatimi doganor nuk bëhet në bazë të asaj sesi e justifikon biznesi kërkesën e vet pasi që të gjitha bizneset mund të vijnë në Qeveri dhe të justifikojnë, mallrat lirohen nga tatimet në baze të asaj se çfarë prioritete ka Qeveria, e cila ka prioritet ta stimulojë një sektor të caktuar dhe e din se nuk prodhohet në vend apo nuk prodhohet. Për këtë arsye duhet të lihet me plotësim dhe ndryshim të ligjit.

Besim Beqaj fton të gjithë që të mendojmë ekonomisht pa paragjykime politike, pa pozicionet që i kemi sepse kjo që po themi nuk është në funksion politik por ekonomik. Nuk është ligji i parë që po ndodh me këtë procedurë por ajo që po kërkojmë me këtë ligj është një sistem unik në rregullimet në rajon dhe me gjërë. Ne gjithë vendet e rajonit Qeveritë mund të marrin vendime për gjëra të tilla, vlerësoj se nuk jemi duke bërë veprim për favore të askujt por veprim për ti ndihmuar ekonomisë. Një numër i madh i ligjeve të shëndetësisë e ka të njëjtën procedurë. Qeveria me një veprim të tillë është duke tentuar që ti thjeshtësojë procedurat, bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për të mundësuar një proces të lëvizjes së shpejtë kur të kërkohet nga ekonomia.

Hasime Krasniqi mendoj se me këtë ligj jemi vonuar mjaft shumë, mosharmonizimi me Komisionin për Legjislacion si një pengesë për bizneset që janë duke pritur që një vit për miratimin e një projektligji të tillë, e shoh të arsyeshme harmonizimin që është bërë në mes të Ministrisë dhe Presidencës, pasi që çdo herë jemi munduar të jemi unik kur është në pyetje interesi i qytetarëve të Kosovës. Kërkoj nga anëtarët e Komisionit ta përkrahin këtë ligj për shkak se shumë bizneseve iu kanë mbetur mallrat nëpër dogana për shkak të mosmiratimit të ligjit.

Albana Fetoshi sugjeroj kabinetin qeveritar që të mendojnë politikisht sepse janë duke menduar si biznesmena, ju ministër e dini që ka edhe politika ekonomike edhe politika sociale dhe ju duhet të punoni më shumë në këtë drejtim, dhe akuza që ne jemi duke i dëmtuar bizneset nuk qëndron sepse nuk jemi duke dëmtuar bizneset për shkak se jemi duke kërkuar që kjo të shkojë përmes Kuvendit.

Besim Beqaj theksoj se nga momenti kur dikush hyn në Qeveri dhe merr punë profesionale duhet të mendojë profesionalisht, në aspektin e politikave ekonomike ende kemi kohë për tu adaptuar, ne po flasim për politikën e mirefillta ekonomike të cilat kërkojnë profesionalizëm dhe në kuadër të profesionalizmit të gjendet politika. Ajo çka po kerkoni ju është komplikimi i jetës ekonomike ekonomisë së Kosovës dhe qytetarëve. Elementi më i vështirë në jetën profesionale dhe politike është mesimi për të degjuar arsyeshëm.

Naser Osmani kemi tentuar që Qeveria respektivisht MF me Komisionin të marrin një vendim të arsyeshëm me një procedurë të shpejtuar, korrigjim që Komisioni do të mund ti bënte Ministrisë nëse do të konsiderohej si jo i mirë. Kemi shkuar me një variant më të avancuar duke dërguar në Kuvend vendimin e Qeverisë në mënyrë automatike nxjerr rezolutë. Personalisht jam për procedura të shkurtëra, jemi në pozicionin ku nuk e kemi ndihmën e Komisionit për Legjislacionin e cila u premtua në Seancë, ata nuk na ofruar versionin sesi do të duhet të ishte.

Kryetarja theksoj se në Seancë Plenare duhet të shkojmë të harmonizuar, nuk e di se procedurat e Kuvendit a lejojnë që të bëhet amendament nga Qeveria në këtë periudhë.

Hykmete Bajrami konstatoj se do të paraqet amendamentin në Kuvend.

Kryetarja sqaroj se për të hyrë amendamenti si pjesë e ligjit duhet të protokolohet dhe të vijë në formën zyrtare. Në Komision nuk na ka adhur asnjë shkresë e nënshkruar, në seancë ka ardhur një leter e dorezuar në emër të Grupit Parlamentar.

Hykmete Bajrami thekson se si pjesë e Komisionit mund të propozoj amendament i cili mund të shkojë me përkrahje apo pa përkrahje të Komisionit.

Kryetarja sqaroj se amendamentet që propozohen nga anëtarët në Komisionin i kemi futur si amendamente të Komisionit dhe kur dëshirojmë që amendamenti të figurojë në raportin të cilin e dorezojmë duhet të vijë në kohë të caktuar. Sipas rregullores së Kuvendit, amendamente në projektligj mund të parashtrojnë deputeti, grupi parlamentar, komisioni, Qeveria në një afat prej dy javësh nga miratimi në parim të cilat pastaj i adresohen komisionit funksionale raportues.

Xhevdet Neziraj konstatoj se në pikepamje ekonomike mund të jemi të ndryshëm por jo në procedura pasi që nga senata kemi dalë për të bërë harmonizimin me Komisionin për Legjislacionin. Mendoj se sërisht në seancë Komisioni për Legjislacionin do të vlerësojë se nuk është i harmonizuar me Kushtetutën. Por nëse i njëjti Komision deklaron se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore atëherë mund ta përkrahim.

Albana Fetoshi theksoj se Ministri e dha një propozim sesi të ndryshohet ky ligj, poashtu propozim i deputetes Bajrami që të fshihet neni 4, konsideroj se në bazë të procedurave të dy amendamentet të votohen në Komision. Nëse deputeti bënë amendament dhe ai nuk votohet në komision atëherë nuk mund të thuhet se nuk kalon, pra duhet të këtë kohë të mjaftueshme që të shkruhet amendamenti.

Kryetarja sqaroj se të gjithë anëtarët e Komisionit propozojnë votohet dhe çdo propozim i Komisionit nuk shkon, propozimi i përkrahur apo jo i përkrahur nga Komisioni. Propozimet që i bëjmë në grupe punuese shkojnë si të Komisionit, nëse deputeti dëshiron të bëjë amendament duhet që edhe anëtarë i Komisionit ti respektojnë procedurat ligjore dhe ta bëjnë në formën e shkruar brenda dy javëve e përcaktuar sipas rregullores.

Albana Fetoshi është e qartë se janë ndjekur të gjithë procedurat që të mos këtë zbrazëti, mirëpo kemi të drejtë që si deputet të mos pajtohemi me përmbajtjen. Çështja tjetër sa i përket amendamenteve mendoj se duhet të shkojnë dy amendamente, kurse amendamenti i nenit 2 nuk ka shkuar jashtë procedurave, nuk është bërë përjashtim sepse deputeti ka dy javë kohë që të bëjë amendamente.

Sali Asllanaj vlerësoj se është konfrontim i dy koncepteve, që Qeveria të formoj dhe ta ndryshoj sipas situatave dhe mundësive, në mënyrë që të jetë krah i fuqishëm i biznesit që mund të fillojë. Nuk është

logjike nëse dikush fillon një biznes të ri dhe ka nevojë për një lëndë të parë nga jashtë dhe ti themi se do ta lirojmë nga dogana sapo të fillojë procedura e ndryshimit të ligjit. Qeveria ka përgjegjësi më të mëdha se ky ligj.

Lulzim Rafuna kur është sjell ligji kemi pas për bazë një përvojë shumë të mirë, i vetmi qëllim tek ky ligj ka qenë që të shkurtohet procedura dhe të ndihmohen bizneset duke pas parasysh luftën për inkurajimin e investitorëve të huaj. Gjatë të kaluarës tek tatimi doganor kemi pas problem pasi që është dashur që investitorit të thuhet të pres gjashtë muaj derisa të ndryshohet ligji, tek tatimi akcizës, tatimi i vlerës së shtuar kemi shkurtuar procedurën duke vepruar në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa. I vetmi tatim i cili ka mbetur pa thjeshtësuar në procedura ka qenë tatimi doganor. Pra, qëllimi ka qenë që të ndihmohen investitorët të huaj që të investojnë në vendin tonë e me këtë i ndihmojmë biznesit të brendshëm. Një element i rëndësishëm juridik është se askush nuk mund të ia ndaloj Kuvendit të drejtën e delegimit një institucioni tjetër për lirin e një malli nga tatimi doganor. Asnjë nen i dispozitës së përgjithshme dhe asaj të veçantë nuk po ndryshohet, po ndryshohet pjesa teknike. Nuk po inicohet procedura për plotësim ndryshim të ligjit por vetëm po i delegojmë Qeverisë që të sjell një akt nënligjor që e liron një mall nga tatimi doganor.

Naser Osmani theksoj se në Seancën e fundit ka qenë e qartë që kjo çështje të trajtohet me procedurën e rregullt, jemi duke diskutuar që kjo kompetencë të i lejohet Qeverisë apo Kuvendi ta mbajë për vete. Nëse dëshiron ta mbajë për vete atëherë duhet të respektohet ndryshimi dhe plotësimi i ligjit në procedura të rregullt. Disponim i opozitës është që kjo kompetencë ti mbetet Kuvendit në këtë rast, së pari duhet të hidhet në votim ajo që është kërkuar nga Komisioni për Legjislacion.

Kryetarja në mënyrë që të mos shtyhet situata, të shkojmë me një rekomandim tjetër dhe Komisioni për Legjislacion ta kthej edhe një herë rekomandoj që të shtyhen këto dy pika të rendit të ditës duke bërë përpjekje që të mbahet një mbledhje e përbashkët për tu harmonizuar.

Me nëntë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Latif Gashi, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama, Albana Fetoshi) një Kundër (Hykmete Bajrami) dhe asnjë Abstenim, Komisioni nxorri këtë

Përfundim

Pika pikat 2 dhe 3 e rendit të ditës shtyhen për shqyrtim, në një mbledhje tjetër të përbashkët në mes Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Legjislacion.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-211 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare “ISTISNA’A” dhe Marrëveshja për Agjencinë “ISTISNA’A” për Financimin e vazhdimet të ndërtimit të rrugës Milloshevë-Mitrovice, Rruga M2, e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim

Besim Beqaj sqaroj se është marrëveshje që Ministria e Financave në harmoni me bazën ligjore, në pajtim me Ministrinë e Punëve të Jashtme ka nënshkruar një marrëveshje në vlerë prej 15.4 mil €. Duke qenë marrëveshje ndërkombëtare me impakt financiar duhet të kalojë në Kuvend. Kostoja është e përballueshme për Qeverinë, janë kushte të volitshme të një huazimi të tillë dhe rekomandojmë që të kalojë në Seancë dhe të aprovohet.

Hykmete Bajrami dëshiroj të dijë kushtet e kredive pasi që kam lexuar se nuk është forma e kamatës por është e rregulluar më ndryshe. A është e favorshme në krahasim me bankat e tjera dhe pse është përzgjedh kjo bankë ?

Besim Beqaj sqaroj se financimi i institucioneve financiare islamike është me procedurë tjetër, sistem tjetër i kreditimeve, kreditime të cilat nuk thirren në bazë të kamate të rregullta por në bazë të ndarjes së rrezikut dhe përgjegjësi në të ardhmen, është shumë më e volitshme si kredi në aspektin e pagesës që duhet ta bëjë shteti në aspektin afatgjatë sesa kreditë që vijnë në institucionet financiare të tjera. Nëse përkthejmë sistemin e tyre në sistemin tonë kamatat janë shumë më të volitshme sesa cilado kredi tjetër.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë :

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj Projektligjin nr. 04/L-211 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare “ISTISNA’A” dhe Marrëveshja për Agjencinë “ISTISNA’A” për Financimin e vazhdimin të ndërtimit të rrugës Milloshevë-Mitrovice, Rruga M2, e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-207 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime që rregullon aktivitetet e Bankës Evropiane për Investimet në Republikën e Kosovës

Besim Beqaj kemi marrëveshje kornizë me Bankën Evropiane për Investime në Republikën e Kosovës, bankë kjo e Komisionit Evropian me kapital që dedikohet nga shtetet anëtare të bashkimit evropian. Në marrëveshjen e nënshkruar nuk ka implikim të drejtpërdrejtë financiar por të ardhmen hap rrugën për marrëveshje të reja sektoriale për projektet që mund të rrjedhin. Jemi në fazën e komunikimi me Bankën Evropiane Investive lidhur me projektet që i kemi më prioritare dhe si mund ti plasojmë ato. Me Ministrinë e Financave jemi duke prodhuar një udhëzim administrativ i cili do ta rregullon çështjen e borxheve të jashtme.

Komisioni, njëzëri nxorri këtë :

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj Projektligjin nr. 04/L-207 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime që rregullon aktivitetet e Bankës Evropiane për Investimet në Republikën e Kosovës.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-210 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare në mes të Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim-Financimi i Dytë Shtesë për Projektin e Pastrimit të Sektorit të Energjisë dhe të Bonifikimit të Tokave-CLRP

Besim Beqaj theksoj se është marrëveshje financiare në mes të Republikës së Kosovës, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim dhe rregullon financimin e dytë shtesë për projektin e pastrimit të sektorit të energjisë dhe të bonifikimi të tokave. Me anë të kësaj marrëveshje Republika e Kosovës do të përfitojë një kredi në vlerë prej 3.2 mil €, projekt ky i cili do të realizohet përmes Ministrisë së Ambientit dhe

Planifikimit Hapësinor dhe KEK-ut dhe synon që të adresoj problemet e trashëguara mjedisore. Përmes kësaj do të mundësohet që KEK-u të lirojë tokën për qëllime të zhvillimit të komunitetit, dhe rregullimin e hirit të Kosova A. Poashtu projekti do të mundësojë që KEKU dhe Ministria e Mjedisit të zbatojnë operacione të vazhdueshme të pastrimit dhe praktikën më të mira mjedisore në sektorin e minierave dhe energjetikës.

Komisioni, njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr. 04/L-210 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare në mes të Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim-Financimi i Dytë Shtesë për Projektin e Pastrimit të Sektorit të Energjisë dhe të Bonifikimit të Tokave-CLRP.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligji nr. 04/L-058

Kryetarja duhet të kemi parasysh që këtë ligj shumë vonë e kemi shqyrtuar, mirëpo prapë kemi pas vërejtje nga komisionin Europian. Ligji është hartuar nga qeveria dhe është pjesë e ligjeve që kanë të bëjnë me pakon e liberalizimit të vizave paraprakisht ju kanë dorëzuar komisionit Europian dhe ju kanë dhënë disa rekomandime për plotësim ndryshim të disa neneve që i ka paraqit qeveria.

Propozojë të shtohet preambule në projektligji sipas standardit. Njëzëri miratohet propozimi që të shtihet preambule në projektligj.

Naser Osmani tek neni 3 paragrafi 2, në praktik mund të ketë telashe tek të hyrat e realizuar në formë të shërbimeve duhet të regjistrohen në kundërt të vlerës monetare të shërbimit. Këtu është problemi sepse kush e cakton këtë vlerë të shërbimit, ne e kemi rastin tek deklarimi pasurisë për zyrtarët e lartë ku duhet të tregojmë vlerën e shtëpisë e në fakt ne nuk dimë cila është vlera reale.

Besim Beqaj arsyeja për amendamentimin e ligjit ka rrjedhë për tri çështje themelore, një për auditimin e raporteve financiare, dispozitat ndëshkimore dhe sa i përket me zgjerua listën e donatorëve të cilët nuk janë të lejuar të japin donacione. Çdo dispozitë në ligj është sipas ligjit siq ka qenë.

Latif Gashi kjo që e ndriti nënkryetari është shumë e rëndësishme, këtë fjali ta bëjmë më të qartë ose ta largojmë ngase është e pamundur për njerëzit që i ekzekutojnë këtë ligj të vlerësohen shërbimet. Realisht nuk e di me qfarë mase vlerësohen shërbimet.

Hykmete Bajrami nëse partitë politike e kanë vullnetin mi paraqit këto shërbime që i marrin sepse siq e tha Ministri për çdo shërbim ka kosto në treg. Besoj që këtu hapësira që të manipulohet me ligjin është tek interpretimi. Sa partitë politike kanë me interpretua këto shërbime në vlerën reale të tyre dhe këtu me pas vjen në pyetje puna e auditorit të cilin e kemi hekur për arsyeje me qenë një auditor i cili i auditon edhe donacionet. Unë mendojë që për secilin shërbim, për dallim prej pasurisë që nuk dimë a ta qesim vlerës sa e kemi ble apo sa e kemi shit për shërbimet në momenteve të caktuara gjithmonë ka një çmim, mirëpo ajo është si e paraqesin apo qfarë vlere i jep subjekti politik. Kjo mendojë që duhet ti lihet auditorit dhe ai le të vjen me gjetje.

Naser Osmani un fola për një çështje që ballafaqohesh në praktikë, p.sh billbordet partisë tonë mund të na jap pa pagesa. Vlera reale e tregut nëse ja kish japë një partie ajër kish kushtuar 1 milion po ne këtë shërbim e regjistrojmë 100 mijë euro. Auditori gjeneralë i përzgjedhur dhe thotë që ju nuk keni paraqitur raportim të saktë sepse kjo kushton 800 mijë euro dhe dënoheni 10%.Kjo është ajo që po them që në praktik çka ndodh se çdo dispozitë e mos paraqitjes së raportimit të saktë ka dispozita ndëshkuese.

Kryetarja kjo do të bëjë që çdo parti politike ti paraqesë në mënyrë imagjinare shumat, p.sh dikush ja ka lëshuar lokalit papara dhe shkruhet vlera e lokalit 200 euro dhe ata vinë dhe thonë në këtë vend është 500 euro ku e detyron partitë politike të shkruaj shuma imagjinare. Tek pika e 4 , a është fjala për këtë ligj apo të ligjit bazik?

Lulzim Rafuna tek pika katër është fjala për ligjin bazik.

Hykmete Bajrami ne i kemi tri ligje dhe kisha propozuar që ne si komision në fund kur ta kryejmë ligjin, ti propozojmë edhe seancës që të bëhet një dokument.

Kryetarja a pajtoheni që nen 3 të shkojë me këto dy ndryshime që u bënë tek ligji bazik

Miratohen njëzëri këto ndryshimet në nenin 3.

Kryetarja tek neni 4 kemi një amendament që ka ardhur nga deputetja Alma Lama dhe thotë të shtohet pika 3 në nenin 4 dhe 10% e shumës së ndarë nga fondi i Kuvendit të Republikës së Kosovës të shkojë për mbështetjen për mbështetjen e punës së secilit deputet. Poashtu amendamenti 2 i propozuar nga deputetja , ku shkruan që partitë politike janë të detyruara të ndajnë buxhetin e tyre nga financimi mbi baza gjinore 30% e shumës së financimit do të shkojë për mbështetjen e aktiviteteve të gjinisë tjetër.

Hykmete Bajrami nuk pajtohem sepse formulimi është shumë i paqartë, d.m.th qfarë ndihme a mund ne të marrim ne 10% të fondit me ble gardëroba?.Nëse duhet ndihmë ekspertizë ose diqka tjetër , sigurisht deputetja e ka pas hallin sepse tash ka mbetur pa grup parlamentar. Asesi nuk pranoj që të holla kesh të merr deputeti dhe mi shpenzue në emër të punës së tij.

Komisioni njëzëri nuk përkrahi amandamentet 1 dhe 2 të deputetes Alma Lama.

Albana Fetoshi tek neni 6 tek pika 1.6 konsiderojë që këto vite janë shumë pakë.

Hykmete Bajrami tek pika 1.6 që thotë tri vite,me sa e kuptova tri vite pas që të kryhet mardhënja kontraktuale mundet me dhanë donacion. Nga këndvështrimi imë kisha thënë që të mos ti jepet kontrata kisha marrë preventive ne praktikat i kemi ndryshe d.m.th organizatat biznesore financojnë fushatat e partive politike më pas marrin tenderë.

Kryetarja konstatojë që neni 6 miratohet pa ndryshim.

Naser Osmani tek neni 8 pika 5 ku thuhet që partitë politike duhet t'i publikojnë dhe të mbajnë të publikuar së paku një vit raportin vjetor financiar të vitit paraprak dhe raportimin e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve paraprake, dhe ta publikojnë versionin e tyre të shkurtuar në njërën nga gazetatat zyrtare. Cilat janë Gazetat Kombëtare dhe pse ti paraqesim në gazetë?

Besim Beqaj kjo është si çështja e reklamimit e cila na ka ardhur disa vite me radhë vërejtje nga Komisioni Europian sa i përket publikimeve dhe kanë konsideruar që është ndikim nëpër media, atëherë është kërkuar nga ne mos të ushtrojmë ndikim përmes publikimeve nëpër media dhe kemi marrë një qëndrim që mos të publikohen fare nëpër gazeta por të jenë në faqe zyrtare dhe kush ka interes le ti merr. Kjo ka pasur ndikim tek mediat, mirëpo në aspektin e raporteve ndërkombëtare në kuadër të raportit të progresit ka dhënë efektin e vet. Kjo është shkak të transparencës por edhe nëse hiqet nuk ka problem.

Albana Fetoshi është mirë që raportet financiare të subjekteve politike të publikohen në web faqen zyrtare mirëpo konsideroj që nuk ka asnjë të keqe të publikohen edhe në gazeta për shkak të transparencës dhe për shkak të mundësisë të informimit të qytetarëve, për shkak se jo të gjithë e shfrytëzojnë internetin.

Latif Gashi përderisa raportet financiar publikohen në web faqe të tyre dhe kanë mundi të gjithë me i pas pse me qenë obligative që ti botojnë edhe në gazetë. Nëse nuk kemi ndonjë vërejtje nga bashkësia ndërkombëtare apo Komisioni Europian unë kisha rekomanduar që pjesa e dytë të largohet dhe mos të jetë e obliguar që të publikohet në gazetë zyrtare.

Naser Osmani kjo është bërë për të rritur transparencën dhe nëse e bëjmë këtë, do ta bëjmë që raportet e partive politike të publikohen në tri gazeta.

Latif Gashi a është kërkesë konkrete e Komisionit Europian që raportet të paraqiten edhe në gazetë?

Enis Spahiu kjo kërkesë është bërë nga Komisionit Europian që raportet të paraqiten edhe në gazeta në formë më të shkurtuara, formatin e të cilave e cakton KQZ-ja .

Me një votë kundër (Albana Fetoshi), asnjë Abstenim dhe të tjetër Për, miratohet ndryshimi në nenin 8, paragrafi 5, në rreshtin e tetë, fjala “kombëtare”, hiqet.

Naser Osmani tek neni 11 , dihet që subjektet politike i raportojë KQZ-së dhe KQZ-ja është dashtë të jetë organi i vetëm që i mbikëqyrë partitë politike pasi që këto i raportojnë. Këtu po kërkohet që një organ krejt tjetër të merr barrën të zgjedhjes dhe caktimit të kontrollit ndaj subjekteve politike. Meqenëse auditori gjeneralë është organi më kompetent i auditimit dhe kontrollit në Kosovë , mirëpo auditori gjeneral nuk e ka kompetencën e auditimit të donacioneve dhe tash këtu mbetet versioni që është i propozuar që është Kuvendi. Këtu përmendet komisioni, komision është organi rekomandues nuk është vendimarrës. Nëse komisioni i përzgjedh këta dhjetë auditori atëherë ai ka marrë vendim, pra kjo kompetencë komisionit nuk mund ti lihet. Atëherë kjo i lihet vendimit të Kuvendit , nga përvoja ime kjo nuk ka kuptim që kuvendi të merret me auditimin e partive politike. Po ashtu këtu thuhet që auditimi të bëhet çdo vit, auditmi bëhet për të audituar fushatën dhe në Kosovë nuk ka çdo vjetë fushatë.

Kryetarja edhe në ligjin tjetër ka qenë që auditori gjeneral ti auditojë subjektet politike dhe se ni komision kem refuzuar për arsye se mundë të ketë donacione edhe në kuadër të partisë dhe nuk është obligativ. Po nëse i shikojmë vendet e tjera në shumicën e tyre auditimi i subjekteve politike bëhet nga auditori i përgjithshëm.

Latif Gashi duke e pas parasysh që auditori i përgjithshëm bënë auditimin vetëm për paranë publike dhe duke pas parasysh se ky ligj ka ardhë plotësim ndryshim shumë herë atëherë është mirë që në këtë nen të bëhen ndryshime vetëm aty ku thuhet Komisioni për Mbikëqyrje të futet edhe administrata e kuvendit duke përfshi edhe ekspertët që do të bëjnë një vlerësim profesional dhe vendimarrjen ta merr komisioni.

Xhevdet Neziri përzgjedhja e auditorëve po kalon nga KQZ-ja tek kuvendi, dua ta di se ku po na rrit kualitetin që përzgjedhja e auditorëve të kalojë në kuvend .

Albana Fetoshi propozoi që auditimin e pasqyrave të subjekteve politike ta bëjë auditori i përgjithshëm kjo ka logjik për shkak që është e pakuptim që një Komision siç është komisioni për mbikëqyrje e financave publike ose cilido qoftë ai të bëjë përzgjedhjen e këtyre auditorëve ska kuptim se në fund të fundit ka mi çuditë pasqyrat financiare të subjekteve politike dhe nuk ka kuptim që ata deputet të bëjnë përzgjedhjen e auditorëve , sepse konsideroj që është konflikt interesi.

Kryetarja te paragrafi 11 pika 2, propozoj që organizimin e konkursit publike për përzgjedhjen e auditorëve të pavarur të oorganizojë sekretaria e Kuvendit, përmes nje komisionit profesional ne muajin janar të çdo viti, të cilët do të audotjnë raporte vjetore financiare të subjekteve politike, sipas kritereve në vazhdim që janë cekur në projektligj.

Hykmete Bajrami edhe sekretaria edhe administrate e kuvendit janë në shërbim të deputeteve dhe në ligj nuk mundemi me fut sekretaria e Kuvendit. Kam biseduar me Kryetarin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, z. Ali Sadriu dhe më ka thënë arsyeja pse është propozuar kështu, Komisioni Evropian është nis prej asaj se komisioni për mbikëqyrje të financave publike, është përgjegjës për përzgjedhjen e auditorit për auditimin e pasqyrave të auditorit të përgjithshëm dhe ata e kanë një kompetencë të tillë dhe proceduara është e njëjtë.

Alban Fetoshi unë instistoj se auditori i përgjithshëm të bëjë auditimin. Nëse kemi pengesa ligjore siç po pretendohet të thuhet këtu, atëherë po propozoj se komisioni qendror zgjedhor të bëjë, por jam kundër që Kuvendi me i përzgjedhë auditorët.

Latif Gashi duke pas parasysh rëndesinë e këtij ligji dhe kushtet tjera, propozoj se te futet vetem fjalia, Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes administratës dhe komisionit për mbikqyrje financiare për përzgjedhjen dhe pjesa e tekstit të vazhdojë.

Nase Osmani te neni 2 nuk mundet me pas auditim vjetor, por auditimi bëhet pas zgjedhjeve.

Latif Gashi mos është qëllimi të auditohen edhe raportet e shpenzimeve tjera vjetore, se nëse e hjekim ndoshta gabojm dhe unë mendoj të jetë kështu, ngase auditohen raportet e shpenzimeve për çdo vit.

Kryetarja theksoi se këtu është edhe nje problem, ata i zgjedhin 10 auditor, e ne i kemi 50 parti politike qysh ndahen auditorët.

Naser Osmani thuhet se raportet e auditimit për subjektet politike i drëgohen agjencionit antikorruption. Nuk kemi të bëjmë me individë apo zyrtar por është qështje e subjektit dhe një subjekt politik nuk mundesh me dërgue në agjensionin antikorruption.

Kryetarja theksoi se raporti i partive politike duhet publikohet në secilën webfaqe të partive politike, sepse sipas ligjit, nëse nuk publikohet, subjekti politik denohet. KQZ-ka, i ka anëtarët e vet dhe le ti hulumton raportet në faqe të internetit.

Latif Gashi i kisha lut përfaqësuesit e qeverisë të jenë pak me këmbëngulës dhe ato që i rekomandojnë përfaqësuesit e Komisionit Evropian, të harmonizohen edhe me problematikat materiale të vendit, por mendojë që kësaj here duhet të kalojm dhe të ecim përpara.

Kryetarja duhet shikuar ligji i agjencisë kundër korrupsionit, për të verifikuar se a është në mandatin e zyres se agjencionit me i marr raportet nga KQZ-ja te partive politike.

Latif Gashi po nuk po shoh diqka qe nuk bënë me dergu në agjencionin antikorruption por edhe nëse nuk e dërgohet ajo ka me e marr atë raport nga partitë politike.

Naser Osmani unë mendojë se n asnjë vend nuk është kështu që subjektet politike me i dërgue raportet tek agjencionin kundër korrupsionit, dhe propozoj të fshihet pika 1.

Kryetarja mendojë që agjencia anti korrupsionit mundet me i kërkuje raportet nga subjektet politike dhe me ngirtë qështjet pastaj në gjykatë, kur vërtetohet se ka shkelje.

Komisioni me një votë Kundër (Albana Fetoshi), asnjë Abstenim dhe të gjithë deputetët tjerë Për, miratuan propozimin për heqjen e paragrafit 11 të nenit 11.

Naser Osmani vlerësoj se diferencat e gjobave e parapara në mes subjeteve të mëdha dhe të vogla politikejanë të mëdha. Në rastin e zgjedhjeve të gjitha partitë janë të barabarta dhe forma si është propozuar paraqet diskrimin sa i përket aplikimit të gjobës. Propozoj që shifra 10% të zvogëlohet në 5%.

Enis Spahiu une nisem prej atij parimi se subjektet e mëdha që marrin para nga fondi kan një përgjegjësi më të madhe.

Naser Osmani ne momentin e shpalljes se zgjedhjeve të gjitha partit janë të barabarta, për hirë të balansimit duhet të zvoglohet në 5 %.

Latif Gashi mendoj që duhet të mbetet siç është propozuar.

Xhevdet Neziraj tregoj se si në bazë të tarifave aktuale, denimet janë palikuar pothuajse njësoj si për partitët e vogla ndoshta me një deputet dhe partitët e mëdha. Mbështet propozimin që shifra të zvogëlohet në 5%.

Komisioni me një votë Kundër (Albana Fetoshi), asnjë Abstenim dhe të gjithë deputetët tjerë Për, miratuan propozimin që në nenin 12, paragrafi 1, në rreshtin e dytë, numri “10%”, zëvendësohet me numrin “5%”.

Naser Osmani sa i përket paragrafit 11 të nenit 12, kjo qështje mundet të perdoret politikisht për eliminimin e figurave politike dhe ka rreziqe të mëdha ti mirret mandati deputetit.

Kryetarja po ashtu në paragrafin 11 të nenit 12, nuk është shkrur kush e verteton shkeljen ligjore, në ligjin bazik ka qenë nga gjykat vërtetohet .

Alban Fetoshi pse duhet me mbetë ky propozim sepse nuk po thotë se ata që i kanë fitu zgjedhjet, por me i verifikue dhe nëse ka keqpërdorime atëherë vazhdojn procedurat e hetimit.

Latif Gashi nëse subjekti politik apo kandidati veretohet nga gjyata se ka bërë keqperdorime te fondit i merret mandati shkurt e qartë. Kjo nuk lejon mundësi spekulimi sepse vërtetohet me vendim të gjykatës. Propozoj që të heqet fjala mund edhe, dhe të mbetet i merret mandati.

Komisioni njëzëri miratoi propozimin, që në nenin 12, paragrafi 11, në rreshtin e tretë, fjalët “mund të”, hiqen. Po ashtu në rreshtin e shtatë dhe tetë, fjalë “*kandidati apo subjekti politik mund edhe t’i*”, zëvendësohen me fjalët “kandidatit apo subjektit politik i”

7. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit për gjashtemujorin e parë të vitit 2013

Ismet Krasniqi theksoi se te kategoria paga e mëditje jemi me një muaj mbrapa, nuk janë pezantuar shpenzimet e mujait të gjashtë, për shkak të pagesave që pagat bëhen në fillim të muajit korrik, ndërkohë kemi disa kontrata për shpenzimet kapitale te cilat janë lidhur me partneret, të cilët kanë aplikuar ne tender të caktuar, dhe presim te realizohen në vazhdim. Shkalla e shpenzimit, është në harmoni me dinamikën e paraparë dhe të miratuar.

Xhevdeti Neziraj vlerësojm se është ndër raportet me të mira të përgaditura dhe duhet të miratojmë.

Latif Gashi kam një sugjerim, që raportet tjera të përgaditen në formën standardet sikurse i dorëzojnë të gjitha organizatat tjera

Sekretari përgaditja sipas formularëve na lehtëson punën, ne për hirë të transparences jemi te interesuar me shku sa ma në detale, perndryshe ne e mirëpresim këtë qëndrim edhe na lehtëson punën si administratë e Kuvendit.

Kryetarja theksoi se tek faqja 11 duhet me përmirësu se llogaritja nuk është bërë mirë. Është mirë që edhe Kuvendit të përgadis raportet sipas formularëve standard dhe ti bashkagjitet raportet në raportimet e ardhshme.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit për gjashtemujorin e parë të vitit 2013

Mbledhja përfundoi: 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona